



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 8 qershor, Trupi Gjykues miratoi Vendimin Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës Kundërshtare ose të një Pjesëmarrësi. Me lëshimin e këtij vendimi kornizë, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për të mos e miratuar këtë vendim kornizë, si dhe kërkesën e ZPS-së dhe të mbrojtësit të viktimave për përfshirjen e një klauzole fleksibël që do t'u lejonte palëve devijimin nga kushtet e Vendimit Kornizë nëse pajtohen se këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

Trupi Gjykues konstatoi se në përcaktimin e një procedure të njëtrajtshme dhe të qartë për t'u ndjekur gjatë kryerjes së hetimeve, Vendimi Kornizë jo vetëm që do të sigurojë një shkallë të përshtatshme mbrojtjeje për dëshmitarët dhe viktimat, por do ta ndihmojë më tej Trupin Gjykues në vlerësimin e çdo pretendimi të mundshëm për ndërhyrje.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 12 qershor, Trupi Gjykues urdhëroi ZPS-në që deri më 14 qershor, të parashtronte kërkesën për dorëzimin e deklaratës me shkrim të një dëshmitari, në vend që ta marrë në pyetje dëshmitarin në sallën e gjyqit. Gjithashtu, Trupi Gjykues urdhëroi Mbrojtjen dhe mbrojtësin e viktimave t'i përgjigjeshin kërkesës së ZPS-së, nëse dëshironin, jo më vonë se më 19 qershor. Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykues udhëzoi Zyrën Administrative të vazhdonte përgatitjet e nevojshme për dhënien e dëshmimeve nga dëshmitarët në sallën e gjyqit, në rast se Trupi Gjykues vendos të hedhë poshtë kërkesën e ZPS-së.

Trupi Gjykues mirëpriti objektivin e ZPS-së për ta përfunduar paraqitjen e provave përpara pushimit veror për garantimin e një gjykimi të shpejtë dhe të së drejtës së z.





Shala për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme. Gjithsesi, Trupi Gjykes thekson se ditët e mbetura për seanca gjyqësore para pushimit veror janë të kufizuara dhe për këtë arsye çdo kërkesë duhet të dorëzohet shpejt.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, gjithashtu më 12 qershor, Trupi Gjykes autorizoi heqjen e disa redaktimeve dhe përfshirjen e redaktimeve të reja në transkriptet e bllokut të parë të dëshmimeve. Trupi Gjykes udhëzoi Administratoren të zbatojë në mënyrën e duhur redaktimet e reja në transkripte dhe videoincizime dhe të riklasifikojë pjesë të transkripteve dhe të incizimeve si publike. Më parë, Trupi Gjykes kishte udhëzuar palët, mbrojtësin e viktimave dhe Zyrën Administrative të dorëzonin propozime për heqjen e redaktimeve dy javë pas përfundimit të çdo blloku të dëshmimeve.

Vendimet e Trupit Gjykes dhe Shtojcën që përcakton Kornizën për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Seanca vijuese në çështjen gjyqësore *Shala* është planifikuar për nesër, 16 qershor, në orën 9:30 të paradites.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i nëntë i thirrur nga Prokuroria përfundoi dhënien e dëshmisë sot. Dëshmitari dha dëshmi me masa mbrojtëse dhe u mor në pyetje nga palët në proces dhe mbrojtësi i viktimave.

Seanca vijuese në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* është planifikuar për të hënë, 19 qershor, në orën 9:30 të paradites.

## Pyetje nga gazetarët

